

RREGULLORE
PER ZGJEDHJEN E PINGPONGISTËVE MË TË MIRË, KLUBIT,
TRAJNERIT, GJYQËTARIT DHE PUNËTORIT SPORTIV PËR VITIN
GARUES

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Zgjedhja e pingpongistëve më të mirë, klubit të pingpongut, trajnerit, gjyqtarit dhe punëtorit sportiv (në tekstin e mëtejshëm, më të mirët) në Federatën e Pingpongut të Kosovës paraqet një nga mirënjohjet publike për rezultatet e arritura dhe kontributin e dhënë në afirmimin e pingpongut si në garat kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Neni 2

Zgjedhjes së më të mirëve i paraprinë baza e rezultateve të arritura në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare .

Për të përcaktuar më lehtë rezultatet e arritura dhe zgjedhjen e më të mirëve, rezultatet garuese do ti paraqesim me numra, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Për të zhvilluar procedurën e zgjedhjes së më të mirëve nëpër kategori të ndryshme duhet paraqitur nga Klubet së paku 3-5 individ në kategorinë e femrave apo meshkujve.

Në rast të mos paraqitjes të numrit minimal të propozimeve të përcaktuar në paragrafin e mësipërm Komisioni për nominime vendos edhe për kandidatin e propozuar apo kandidatët e propozuar nëse janë dy duke marrë për bazë edhe të dhënave të grumbulluara nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 4

Për zgjedhjen e më të mirëve vlerësohen rezultatet e arritura në garat zyrtare të organizuara nga Federata në vendin tonë si dhe ato të organizuara nga Federata botërore, Unioni Evropian, Mediteran dhe Ballkanik.

Evidenca e rezultateve nga garat kombëtare dhe ndërkombëtare mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 5

Zgjedhja e pingpongistëve, ekipit dhe klubit të Pingpongut më të mirë bëhet në konkurrencën e meshkujve dhe femrave për të katër kategoritë: minikadetë, kadetë, Juniorë dhe Seniorë.

Neni 6

Kandidimin për zgjedhjen e më të mirëve mund ta bëjnë Klubet, Komiteti i trajnerëve, Komiteti i Gjyqtarëve të cilat janë anëtare fuqiplota në FPPK.

Klubet dhe Komitetet mund të japin vetëm nga një propozim për individin apo ekipin për secilën konkurrencë (M-F) dhe kategori (MN, K, J, S).

Klubet apo Komitetet nëse nuk kanë përmbushur obligimet eventuale ndaj Federatës si dhe në rastin kur Klubi - kandidati i propozuar ka masa disiplinore të shqiptuara që ende është në fuqi nuk mund të kandidojnë përfaqësuesit e vet për zgjedhjen e më të mirëve.

II. KRITERET PER ZGJEDHJEN E MË TË MIRËVE PËR VITIN E KALUAR GARUES

Neni 7

Në procedurën e zgjedhjes së më të mirëve, zbatohen këto kriterë :

- rezultatet e Klubit nga Kampionati ekipor i Kosovës,
- rezultatet nga Kupa e Kosovës,
- rezultatet nga Liga Dardania,
- rezultatet nga Takimet mediterane, si dhe
- rezultatet nga ndonjë garë tjetër ndërkombëtare

Në rast të pikëve të barabarta të klubeve përparësi i ipet klubit që ka rezultat më të mirë në takimet mes veti

Për Trajner merren rezultatet e Klubit dhe ato individuale të pingpongistit, për gjyqtar merren vlerësimet që i janë bërë nga Gjyqtari Suprem dhe vlerësimet nga pjesëmarrja eventuale në garat ndërkombëtare, ndërsa për punëtorin sportiv merret i gjithë kontributi i tij në FPPK.

Neni 8

Vlerësimi i pikëve për Klube bëhet varësisht nga niveli i pjesëmarrjes dhe rëndësia e garave.

Neni 9

Për Kampionatin ekipor të Kosovës dhe Ligën Dardania vlerësimi është i këtillë :

Vendi I = 100 pikë,

Vendi i II = 90 pikë

Vendi i III = 80 pikë

Për Garat Mediterane vlerësimi është i këtillë :

Vendi I = 200 pikë,

Vendi i II = 150 pikë

Vendi i III = 100 pikë

Për Kupën e Kosovës vlerësimi është i këtillë :

Vendi I = 50 pikë,

Vendi i II = 40 pikë

Vendi i III = 30 pikë

Neni 10

Vlerësimi i Klubit më të mirë sipas **kategorive** bëhet si në Tabelën nr.1

Tabela I

Tabela e vleresimit per Klube sipas kategorive											
Nr	Klubi	kategoria	Kampionati ekipor		Kupa e Kosoves		Liga Dardania		Garat Mediterane		Piket totale
			vendi	Piket	vendi	Piket	Vlera	Piket	Vlera	Piket	
1		Junior	1	100	1	50.00					
2		Junior	2	90	2	40.00					
3		Junior	3	80	3	30.00					
1		Seniore	1	100	1	50.00	1	100.00	1	200.00	
2		Seniore	2	90	2	40.00	2	90.00	2	150.00	
3		Seniore	3	80	3	30.00	3	80.00	3	100.00	
1		Senior	2	90	1	50.00	1	100.00	1	200.00	
2		Senior	1	100	2	40.00	2	90.00	2	150.00	
3		Senior	3	80	3	30.00	3	80.00	3	100.00	

Neni 11

Vlerësimi i Klubit më të mirë me të gjitha kategoritë/ Senior M, Seniore F dhe Junior/ bëhet si në Tabelën nr.2 .

Pikët e mbledhura nga të gjitha kategoritë japin fituesin.

Tabela 2

Tabela e vlersimiti per klube																					
Nr	Klubi	Selia	Liga e Kosoves												L. Dardania		Garat Mediterane		total		
			Superliga		Liga e femrave		liga e juniorve		liga e pare		LIGAT		Liga e femrave		liga e juniorve		Vendi	pike		Vendi	Pike
			vendi	Pike	vendi	Pike	Vendi	Pike	Vendi	Pike	vendi	Pike	vendi	Pike	Vendi	Pike					
1																					
2																					
3																					
4																					
5																					
6																					
7																					
8																					
9																					
10																					
11																					
12																					
13																					
14																					

Neni 12

Vlerësimi i Pingpongistit më të mirë në garat individuale bëhet varësisht nga niveli i pjesëmarrjes dhe rëndësia e garave.

Neni 13

Për renditjen e pingpongistit në Ranglistën e Kosovës vlerësimi është i këtillë :

Vendi I = 100 pikë

Vendi i II = 90 pikë

Vendi i III = 80 pikë

Për pjesëmarrjen e lojtarit në Kampionatin botëror (ITTF), Kampionatin Evropian(ETTU), Garat Mediterane (MTTU), Kampionatin Ballkanik (BTTU) apo Turnet e hapur si dhe për fitoret eventuale qoftë në garat individuale apo në ato ekipore merren këto pikë:

ITTF

- pjesëmarrja = 30 pikë
- 1(një) fitore = 10 pikë.

ETTU

- pjesëmarrja = 20 pikë
- 1(një) fitore = 8 pikë.

MTTU

- pjesëmarrja = 10 pikë
- 1(një) fitore = 7 pikë.

BTTU

- pjesëmarrja = 10 pikë
- 1(një) fitore = 5 pikë.

Turne i hapur ndërkombëtar

- pjesëmarrja = 5 pikë
- 1(një) fitore = 3 pikë.

Mbledhja e pikëve nga tabela 3 dhe 4 jep pingpongistin-en më të mirë në kategorinë e vet.

Tabela nr.3

Klubi	Kategoria	Ranglista e KOS		ITTF				ETTU				MTTU				Piket Tab.4
		vendi	Pikë	Pjes.	Fit.	Pikë	TOT	Pjes.	Fit.	Pikë	TOT	Pjes.	Fit.	Pikë	TOT	
	Minikadete	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Minikadete	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Minikadete	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Minikadet	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Minikadet	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Minikadet	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Kadete	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Kadete	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Kadete	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Kadet	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Kadet	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Kadet	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Juniore	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Juniore	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Juniore	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Junior	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Junior	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Junior	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Seniore	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Seniore	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Seniore	3	80	30		10		20		8		10		7		
	Senior	2	90	30		10		20		8		10		7		
	Senior	1	100	30		10		20		8		10		7		
	Senior	3	80	30		10		20		8		10		7		

Tabela 4

Klubi	Kategoria	BTU				TURNE TE HAPUR				Piket Tab.4
		Pjes.	Fit.	Pikë	TOT	Pjes.	Fit.	Pikë	TOT	
	Minikadete	10		5		5		3		
	Minikadete	10		5		5		3		
	Minikadete	10		5		5		3		
	Minikadete	10		5		5		3		
	Minikadete	10		5		5		3		
	Minikadete	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Kadet	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Junior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		
	Senior	10		5		5		3		

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Vlerësimin e rezultateve të kandidatëve për zgjedhjen e më të mirëve sipas kategorive, në konkurrencën e meshkujve dhe femrave në të dhënave të besueshme e bën Komisioni për nominime i përbërë nga 3 anëtarë, të cilin e emëron Bordi i FPPK-së. Në rast eventual të propozimit për kandidat për nominim të anëtarit të komisionit, kandidati i propozuar humb të drejtën e votës dhe nuk merr pjese në pozitën e propozuar për nominim.

Neni 15

Vendimin mbi shpalljen e më të mirëve e nxjerr Bordi i FPPK-së.

Neni 16

Shpërblimet të cilat ndahen në solemnitet me rastin e shpalljes së më të mirëve për vitin e kaluar garues i siguron FPPK.

Shpërblimet e ndara ekskluzivisht kanë karakter sportiv.

Neni 17

Nxjerrja e Rregullores si dhe ndryshimet e plotësimet bëhen nga Kuvendi i FPPK-së.

Neni 18

Rregullorja nuk mund të ndryshohet 30 ditë para shpalljes së e më të mirëve. Interpretimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Bordi i FPPK-së.

Neni 19

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovuar në Kuvendin e FPPK-së.

Kryetari i FPPK-së